

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

DPS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me:

- Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
- Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
- Alb-Konfindustria, Tiranë
- Agjencinë Rajonale të Zhvillimit, Korçë
- Laboratorin Kibe 1, Durrës
- Institutin e Ndërtimit, Tiranë

Këto marrëveshje kane për qëllim ndër të tjera të theksojnë:

- rëndësinë që ka bashkëpunimi midis institucioneve të infrastrukturës së cilësisë dhe atyreve që merren me zhvillimin ekonomik,
- rëndësinë, rolin dhe përfitimet që rrjedhin nga një bashkëpunim i ngushtë midis palëve të interesuara për zhvillimet më të fundit teknologjike në fushën e sigurisë dhe cilësisë së produkteve e shërbimeve,
- ndikimin pozitiv që kanë standardet dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit në zhvillimin e ekonomik të vendit dhe në marrëdhëniet tregtare rajonale e ndërkombëtare.

Gjithashtu, këto marrëveshje synojnë një sensibilizim të aktorëve të ekonomisë për pjesëmarrje me aktive të tyre (kryesisht të eksperteve të fushave të ndryshme të biznesit/ kompanive) në Komitetet Teknike të DPS dhe në procesin e hartimit, adoptimit, miratimit dhe përkthimit të standardeve Shqiptare.

Shtrirja e këtij bashkëpunimi në qytete të tjera përveç Tiranës, ka për qëllim çuarjen më pranë biznesit dhe strukturave të zhvillimit rajonal teknologjinë më të fundit në nivel European e Ndërkombëtar, standardet Europiane e ndërkombëtare për të gjitha fushat e ekonomisë.

Në këto marrëveshje DPS i cakton palët nënshkruese si shitës zyrtarë të standardeve Shqiptare përkundrejt termave financiare të rëna dakord nga palët.

Gjithashtu, në këto marrëveshje, DPS inkurajon shumë iniciativat e individëve apo kompanive të ndryshme të kontribuojnë financiarisht në përkthimin në gjuhën shqipe të standardeve Shqiptare.